



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 4266/2021  
Data: 14.06.2021

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 18.05.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Kërkesa e kompanisë "Elkon" sh.p.k për dhënien e pëlqimit në parim.
3. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## 2. Kërkesa e kompanisë “Elkon” sh.p.k për dhënien e pëlqimit në parim.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kompania në fjalë para dy viteve ka parashtruar kërkesë dhe kuvendi ka marr vendim për dhënien e pëlqimit në parim, mirëpo kompania ka parashtruar kërkesë për dhënien e pëlqimit për këtë pjesën më poshtë. Në dokumentacion ishin edhe pëlqimet e autoritetit rajonal dhe të Ministrisë së Ambientit. Siç e keni parë në kërkesë këto janë do hidrocentrale shumë të vogla dhe praktikohen. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- është diskutuar në mbledhjen e kaluat të KPF-së sepse fillimisht është ardhur një kërkesë për ndryshim të lokacionit dhe ne kemi kërkuar të shtrohet kërkesë e re dhe përsëri e përcjellim për kuvend, mirëpo çështja e hidrocentraleve në nivel të lartë është problem sepse kanë me u rishikuar të gjitha lejet e dhëna për hidrocentral. Unë jam që me proceduar në kuvend dhe është mirë që drejtoria me njoftuar parashtruesin e kërkesës që me marr pjesë në mbledhje të kuvendit të komunës.

**Refet Kalisi** thekson:- un jam pro hidrocentralit por ne vetëm po japim pëlqime por asnjë herë nuk po investojnë. Komuna e ka projektin për rregullimin e lumit Lepenc a e prish pamjen e projektit të lumit Lepenc.

**Teuta Shkreta** thekson:- pse kompani është përqendruar vetëm në atë pjesë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ky lloj i hidrocentralit është i tipit digë pa kanal dhe nuk e prishë pamjen e projektit për lumin Lepenc. Është përqendruar në atë pjesë për shkak se është vend më i përshtatshëm dhe ka qasje në rrugë por në mbledhje të kuvendit të komunës do të na i sqaron parashtruesi i kërkesës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- të gjitha shqetësimet që i kemi është mirë që parashtruesit të kërkesës me ja bërë në kuvend po ashtu edhe shqetësimin që e dha z.Refet Kalisi është shqetësim i të gjithë neve, mirëpo ajo që po më doket që është qesharak se ne po japim pëlqime por nuk po bëhet asgjë e që po i bien që kompanitë me luajtur me komunën dhe komuna nuk po del serioz . Është mirë që kompani me na garantuar se a ka pasoja të mëvonshme ky projekt në mënyrë që mos me pas ndonjë problem në të ardhme sepse si komunë nuk jemi kundër askujt për me i dhënë pëlqim.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA E KOMPANISË ELKON SHPK PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

### 3. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- në informatë i kemi paraqitur faktorët ndotës, rezultatet e monitorimit të stacionit të ajrit, normat e cilësisë së ajrit sipas udhëzimit administrativ, rezultatet e monitorimit të cilat janë me ligj që me u matur dyoksidi i sulfurit, dyoksidi i azotit, monoksidi i karbonit pm 10 pm 2.5. Janë bërë disa krahasime në raport me vitin 2019 . Ndotja nga kompania “Sharrcem” dhe ndotja e tokës. Në përgjithësi ajri në krahasim me vitin e kaluar ka përmirësim të cilësisë së ajrit dhe kjo vjen si rezultat i përfundimit të punimeve të autostradës. Po ashtu kompania “Sharrcem” e ka mbyllur hallën e klinkerit. Kanë ndikuar në përmirësim të ajrit edhe masat e Qeverisë për parandalimin e kovidit. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ambienti në Han të Elezit nuk është i pastër sepse po që se e pastron veturën paradite, pasdite bëhet sikur se nuk e ke pastruar hiq . Ambienti po të krahasohet me qytete e tjera jemi komunë që hynë në mesin e komunave të ndotura. E diskutuam edhe kërkesën e kompanisë “Elkonë” sa mundet me ndikuar në ruajtjen e ambientit dhe ne mund ta diskutojmë me këtë kompani që në të ardhmen me investuar diçka në çështje të ambientit. Është mirë që edhe rrugët të pastrohen për shkak se ka pluhur dhe duhet të veprojmë që ambienti të jetë më i pastër.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që te kompanitë të cilat e ndotin ambientin duhet të kërkojmë që të investojnë në projekte. Është kompania “Alba” e cila vepron në fshatin Seçishtë dhe është ndotësi më i madh atje dhe nuk bënë asnjë investim . Është normale nëse kërkojmë edhe nga kompania “Sharrcem” me investuar në projekte për shkak se është ndotësi më i madh.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kompania “Sharrcem” dhe kompania “Alba” i kanë pëlqimet mjedisore për shkak se nuk ka mundur me ja filluar biznesit pa i pasur këto dokumentacione por varet sa i respektojnë dhe normalisht ndoshta shkaktojnë edhe pluhur por policia nuk reagon edhe komuniteti nuk reagon. Ndotje janë duke sjellë veturat e vjetra, parkingu që është i kompanisë “Sharrcem” për të cilin kemi diskutuar dhe kanë pasur me mbyllur por për shkak pandemisë nuk kemi pas takime dhe përsëri duhet ta shikojmë këtë çështje.

**Refet Kalisi** thekson:- kompania “Sharrcem” është ndotësi më i madh pavarësisht a duam apo nuk duam ta pranojmë dhe nuk jam kundër diçka për shkak se e kemi interesin si qytetarë të komunës së Hanit të Elezit. Çështja e parkingut është shumë keq sepse shkakton ndotje por është problem edhe siguria. Pavarësisht që mund të pastrohet asfalti po përsëri ndotet nga kamionët për shkak se kompania “Sharrcem” nuk ka ndikuar asgjë për atë parking.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA MBI MBROJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sabedin Hasallari** thekson:- rruga që shkon në drejtim të fshatit Gorancë po ka vozitje të shpejta dhe është mirë me i vendosur pengesa afër kompanisë që e kam sepse po rrezikohen edhe qytetar të cilët qarkullojnë në këmbë.

**Kryesuesi** thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës ; nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:34

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**

